

FATCA

Akti për Përputhshmërinë Tatimore të Llogarive të Huaja (“FATCA”) është një ligj amerikan objektivi i të cilit është të luftojë evazionin tatimor nga tatimpaguesit amerikanë. Shërbimi i Brendshëm i të Ardhurave (“IRS” – autoritet tatimor i SHBA) ka hartuar një strukturë për të mbledhur nga institucionet financiare joamerikane, në bazë vjetore, informacione lidhur me të ardhurat e huaja dhe asetet e mbajtura nga tatimpaguesit amerikanë jashtë Shteteve të Bashkuara.

Duke filluar nga data 1 Korrik 2014 institucionet financiare, si Bankat, kompanitë e sigurimit të jetës, kompanitë e menaxhimit të asetëve, kujdestarët (mbajtësit), etj., do të duhet të përcaktojnë procedura për të identifikuar klientët e tyre amerikanë. Gjatë vitit 2016, institucionet financiare kanë nisur raportimin në autoritetet tatimore amerikane të Identitetit dhe Numrit të Identifikimit Tatimor të klientëve të tyre amerikanë si edhe tepricat e llogarive të tyre në datën 31/12/2015. Informacione shtesë mbi të ardhurat, dhe më pas të ardhurat bruto që rezultojnë nga shitja e letrave me vlerë do të shtohen progresivisht në raportim në vitet në vijim.

Në mënyrë që të lehtësojnë implementimin e FATCA një numër i madh vendesh kanë negociuar marrëveshje ndërqeveritare me SHBA. Këto vende do të duhet të përshtasin legjislacionin e tyre kombëtar me kërkesat e raportimit tatimor të FATCA, në këtë pikë Shqipëria nuk e ka nënshkruar ende këtë marrëveshje me SHBA.

Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a si pjesë e grupit Uniqa Insurance Group njih rëndësinë e FATCA dhe vepron në përputhje me kërkesat saj. Përbushja e kërkesave për identifikim dhe raportim të klientëve bazohet në dhënien e pëlqimit nga ana e tyre.

I gjithë ky proces zhvillohet nga kompania duke respektuar kërkesat e Ligjit vendas nr.9887 dt. 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Kompania jonë ka përfunduar me sukses procesin e regjistrimit në portalin IRS duke marrë dhe numrin përkatës të identifikimit (GIIN) :GMPXWL.00005.ME.008

Formularët FATCA i gjeni më poshtë:



FORM
W-8BEN-E.pdf



fORM W-8BEN.pdf



form W-9.pdf



form W- 8IMY.pdf